

QËNDRIM ADVOKUES MBI PËRAFRIMIN E AKTIT TË SHËRBIMEVE DIGJITALE (DSA) NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Si pjesë e përpjekjeve tona rajonale për të garantuar përafrimin ligjor të Ballkanit Perëndimor me Aktin e Shërbimeve Digjitale (DSA) të Bashkimit Evropian - një akt ligjor veçanërisht i rëndësishëm - organizatat e shoqërisë civile në rajon kanë dakordësuar një qëndrim të përbashkët advokues.

Ky qëndrim përqendrohet tek modelet mundësuese dhe ndërhyrjet prioritare të cilat mbështesin sundimin e ligjit, mbrojnë lirinë e shprehjes dhe të medias, dhe garantojnë të drejtat e njeriut. Duke u përqëndruar në këto fusha kritike, synojmë të nxisim zbatimin efektiv të DSA-së në mënyrë që reformat në shërbimet digjitale të mos komprometojnë liritë themelore.

Qasja jonë informohet nga përvoja në fushën e medias dhe rregullimit të platformave dhe gjetjet e studimeve të fundit si [hulumtimi ynë](#) mbi zbatimin e DSA-së në rajon dhe një publikim i [Share Foundation](#).

NDËRHJRJET PRIORITARE NË NIVEL RAJONAL

1. VIJAT E KUQE NË QASJEN NDAJ AKTIT TË SHËRBIMEVE DIGJITALE

Për një zbatim të saktë të DSA-së në Ballkanin Perëndimor, është thelbësore të shmangen keqinterpretimet dhe keqzbatimet që mund të çenojnë objektivat e tij:

- › **Qeverisje e përmbajtjes, jo kontroll i përmbajtjes:** DSA duhet të përqendrohet në rregullimin e proceseve të qeverisjes së përmbajtjes, jo në kontrollin e drejtpërdrejtë të përmbajtjes si gjuha e urrejtjes, dezinformimi, apo mediat *online*. Një qasje e tillë respekton lirinë e shprehjes dhe shmang censurën.
- › **Asnjë rregullim në nivel kombëtar të platformave *online* shumë të mëdha (VLOPs) dhe motorëve të kërkimit shumë të mëdhenj (VLOSEs):** Rregullimi i këtyre platformave mbetet përgjegjësi e Komisionit Evropian, veçanërisht në lidhje me detyrimet e *due diligence*. Ndërhyrjet në nivel kombëtar mund të krijojnë mjedise rregullatore të përçara dhe jokonsistente, çka do të çenonte zbatimin e njëtrajtshëm të DSA-së.
- › **Qëllimi legjislativ i DSA-së është i qartë:** DSA nuk synon të reduktojë gjuhën e urrejtjes, dezinformimin, apo të rregullojë mediat online, por synon garantimin e proceseve të sigurta, të qarta dhe llogaridhënese të qeverisjes së përmbajtjes.

2. MUNDËSIMI I MODELIT TË DSA-SË

Zbatimi i saktë dhe koherent i DSA-së në rajon varet nga masat e mëposhtme:

- › **Përfaqësues ligjorë të platformave:** Platformat që operojnë në rajon duhet të caktojnë përfaqësues ligjorë ose pika kontakti të dedikuara në secilin vend për të garantuar komunikim efektiv dhe pajtueshmëri me rregullimet vendase.
- › **Masa mbrojtëse kundër përmbajtjes së paligjshme:** DSA parashikon garanci procedurale, si kërkesa dhe njoftime të qarta për fshirjen e përmbajtjes, si dhe mekanizma ligjorë të fortë për të trajtuar përmbajtjen e paligjshme në mënyrë efikase, duke respektuar të drejtat e përdoruesve.
- › **Sinjalizuesit e besuar:** Krijimi i programeve të sinjalizuesve të besuar dhe të pavarur do të ndihmojë në lehtësimin e proceseve të moderimit të përmbajtjes dhe rritjen e përgjegjësisë së platformave, duke ruajtur pavarësinë e sinjalizuesve nga ndikimet e papërshtatshme.
- › **Aksesi në të dhëna për hulumtime:** Lehtësimi i qasjes në të dhëna për hulumtuesit është vendimtar për transparencën dhe përgjegjësinë në veprimtarinë e platformave, në mënyrë që hulumtimet të informojnë masat e ardhshme rregullatore.
- › **Pavarësia dhe qasja shumëaktoriale në zbatimin e DSA:** Nxitja e një zbatimi të pavarur të DSA-së që angazhon aktorë të ndryshëm, përfshirë shoqërinë civile, garanton që DSA të jetë në përputhje me kontekste dhe nevoja lokale, teksa ruan të drejtat themelore.
- › **Pavarësia e Koordinatorit të Shërbimeve Digjitale (DSC):** Sigurimi i pavarësisë institucionale, politike dhe financiare të DSC-ve është thelbësor për zbatimin e paanshëm të DSA-së, duke ruajtur transparencën, llogaridhënien dhe mbrojtjen e të drejtave themelore, si dhe duke parandaluar konfliktet e interesit të DSC-ve me entitete qeveritare apo korporative.
- › **Bashkëpunimi midis Koordinatorëve të Shërbimeve Digjitale:** Bashkëpunimi efektiv midis DSC-ve kombëtare, Bordit Evropian për Shërbimet Digjitale, Komisionit Evropian dhe DSC-ve të Shteteve Anëtare është thelbësor për zbatimin pa pengesa të DSA-së ndërmjet kufijve.

3. PJESËMARRJA E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE (OSHC)

Në përputhje me kornizën e qeverisjes së DSA-së, shoqëria civile luan një rol thelbësor në procesin e përafrimit me DSA-në, dhe përfshirja e saj duhet të inkurajohet në mënyrë aktive në:

- › **Themelimin e DSC-ve dhe lehtësimin e punës së tyre:** Në hulumtimin tonë, kemi propozuar tre modele të themelimit të DSC-ve dhe formave të përfshirjes të shoqërisë civile që do të shqyrtohen më tej në konsultim të ngushtë me Komisionin Evropian.
- › **Krijimin e një rrjeti rajonal ekspertësh dhe aleatësh:** Ky rrjet do të ofrojë një sistem mbështetës për zbatimin e DSA-së, duke lehtësuar shkëmbimin e përvojave dhe duke bashkërenduar përpjekjet e advokimit.
- › **Rritjen e ndërgjegjësimit të OSHC-ve:** Është thelbësore të edukohen aktorët e vendeve të rajonit mbi parimet e DSA-së dhe ndikimin e saj në mjedisin ligjor vendas, për të shmangur keqkuptimin se DSA është një mjet për rregullimin e gjuhës së urrejtjes apo dezinformimit *online*.

Duke pasur parasysh këtë, u bëjmë thirrje aktorëve në shtetet e Ballkanit Perëndimor, organizatave ndërkombëtare, donatorëve, dhe veçanërisht Komisionit Evropian, që të përkrahin kornizën transformuese të DSA-së për përmirësimin e qeverisjes digjitale në të gjithë rajonin.

Duke iu përmbajtur vijave të kuqe dhe duke zbatuar masat mundësuese, rajoni mund të shfrytëzojë DSA-në për të nxitur një hapësirë digjitale më të sigurtë dhe më të përgjegjshme. Përfshirja aktive e të gjithë aktorëve, përfshirë shoqërinë civile, dhe ndërhyrjet e bashkërenduara në nivel rajonal, do të sigurojë që DSA-ja të zbatohet në një mënyrë që respekton kontekstet vendase, por gjithashtu garanton një qasje të qëndrueshme dhe ligjërish të unifikuar me vlerat e Bashkimit Evropian.

Nisma udhëhiqet nga Partnerët për Ndryshim Demokratik Serbi dhe zbatohet nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (Shqipëri), Fondacioni Metamorphosis (Maqedoni e Veriut), NVO 35 mm (Mali i Zi), Women in Tech (Kosovë), and Zasto Ne? (Bosnje dhe Hercegovinë), me mbështetjen financiare të Open Society Foundations Western Balkans.